



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**QENDRA KOMBËTARE E KULTURËS PËR FËMIJË**

Nr. 1/ 2 prot

Tiranë, më 28/01/2021

Relacion mbi

Monitorimin e buxhetit per 12-mujorin e vitit 2020

Qendra Kombëtare e Kulturore për Fëmijë ka për qëllimin edukimin dhe argëtimin e fëmijëve, kultivimin e prirjeve, talenteve, formimin e shprehive dhe shkathtësive. QKKF shërben për njohjen, ruajtjen dhe forcimin e traditës kombëtare, edukon atdhedashurinë, si dhe ndihmon për njohjen e vlerave të kulturës botërore.

Në shërbim të edukimit dhe argëtimit, zhvillimit të lirë të mendimit dhe krijimit, talentit dhe aftësisë, QKKF organizon veprimtari shkollore e ndërshkollore, kombëtare dhe ndërkombëtare si: konkurse, olimpiada, festivale, ekspozita, ekskursione, promovime librash, takime me shkrimtarë, kompozitorë, piktorë, aktorë, etj.

Gjatë periudhës Janar-Mars 2020 QKKF, TK ka vënë në skenë 2 premiera artistik “ Qullaci i Hekurt” dhe “Maçoku me çizme” ka dhënë 53 shfaqje teatrale ne Teatrin e Kukullave me 5,831 spektator/audiencë dhe ka realizuar një ekspozitë pikturë dhe skulpturë me fëmijët e Qendrës, ku morën pjesë 30 fëmijë dhe 204 spektatorë.

Gjithashtu janë realizuar 4 aktivitete me fokus edukimin artistik “Ora e Përrallava”, me pjesmarjen e 50 fëmijëve dhe 390 spektatorëve.

Gjatë periudhës Mars-Gusht 2020 të gjitha aktivitetet e QKKF u pezulloan për shkak të situatës së jashtëzakonshme të COVID 19.

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2020 QKKF, TK ka vënë në skenë një premierë artistik “Vitamina e jetës”, ka realizuar me fëmijët e Qendrës “Festivalin e kercimit”, “Ngjyrat e nentorit” dhe “Klipi i vitit të Ri”

Viti 2020 përkoj me 70-Vjetorin e Teatrit të Kukullave i cili edhe pse ishte planifikuar që të realizohej në sallë, me pjesmarjen e të gjithë artistëve dhe punonjësve që kanë kontribuar për dekada për këtë institucion, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të COVID 19 u realizua me rregjistrime dhe u transmentua pothuajse në të gjitha kanalet televizive.

Nga fondet e buxhetit vjetor plani i periudhës progresive për vitit 2020 në shumën prej 35,011,000 lekë janë shpenzuar 32,407,000 lekë ose 93% e tyre. Ndërsa fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore u realizuar në masën 99.7 %.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**AGIM BAJKO**